



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE SEKRETARËT E
KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kodi Zgjedhor, neni 29, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, përcakton se anëtarët e KZAZ-së, emërohen nga KQZ sipas procedurës:

Dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet barazpeshimi politik, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në barazpeshimin politik shumicë-opozitë. Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia

e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare. Sekretari i KZAZ-së propozohet nga partia politike që propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së.

Nga ana tjetër, vetë legjislatori ka përcaktuar një dispozitë kalimtare, nenin 183, pika 3 të Kodit Zgjedhor, e cila është e aplikueshme në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore pas hyrjes në fuqi të amendimeve të vitit 2020.

Bazuar në dispozitën kalimtare të legjislatorit, e cila gjeti zbatim në zgjedhjet e para të përgjithshme (zgjedhje të vitit 2021), përcaktohet qartë se nga rezultati i zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, do të caktohen partitë politike që do të kenë të drejtë të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Administrimit Zgjedhor edhe në zgjedhjet e para vendore të datës....2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zgjedhjet e vitit 2021, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 (vendimi nr. 555, datë 26.07.2017, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë), pas komunikimit zyrtar me Kuvendin e Shqipërisë, dhe konsultimit publik me partitë politike, me vendimin nr. 40, datë 23.12.2020 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021” vlerësoi dhe vendosi që:

Partia socialiste e Shqipërisë, parti kryesore e shumicës parlamentare, do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ.

Partia Social Demokrate, parti e dytë e shumicës parlamentare do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ.

Partia Demokratike, parti kryesore e opozitës parlamentare do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ.

Lëvizja Socialiste për Integrim, e ndryshuar me emrin Partia e Lirisë, parti e dytë e opozitës parlamentare do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ.

Sa më sipër, edhe në zgjedhjet e para vendore të datës 14 maj 2023, do të ndiqet e njëjta praktikë si në zgjedhjet e para të përgjithshme të vitit 2021, sikundër legjislatori kërkon.

Referuar parashikimeve të nenit 29, paragrafi 1, gërma “b”, anëtari i shtatë në gjysmën e KZAZ-ve do të propozohet nga partia Socialiste e Shqipërisë, parti e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, parti e parë e opozitës parlamentare.

Erion Meta Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Majlinda Çelmeta Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: ... 12.2022

Nr:

Ora::.....

PROJEKTVENDIM

PËR

**PÛRCAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE SEKRETARËT E
KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 4, nenit 183, pika 8, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), që do të ngrihen dhe funksionojnë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, si më poshtë:
 - a) Dy anëtarë në çdo KZAZ propozohen nga Partia Socialiste e Shqipërisë,
 - b) Një anëtar në çdo KZAZ propozohet nga Partia Social Demokrate,
 - c) Dy anëtarë në çdo KZAZ propozohen nga Partia Demokratike,
 - d) Një anëtar në çdo KZAZ propozohet nga Partia e Lirisë.
2. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të propozohet në përputhje me rezultatet e shortit të hedhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike.
3. Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:
 - a) Nga partia Socialiste e Shqipërisë në KZAZ-të, ku Partia Socialiste ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së;

Data:2023 Nr:
Ora:



"Për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

- b) Nga Partia Demokratike në KZAZ-të, ku Partia Demokratike ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së.
4. Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë të KZAZ-ve jo më vonë se data 29.01.2023.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI